Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Taksa postale e paguese

RILINDJA

DEL DY HERE NE JAVE: TE ENJTEN DHE TE DIELLEN
Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1
PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —
Dorshkrimet nuk kthehen
Drejtori pergjegjes SEDAT BIDA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vjeti IV Nr. 167 | PRISHTINE, e dielle 12 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Fjalimi i shokut Eduard Kardel ne plenumin e zgjanuem te keshillit te pergjithshem te Frontit popullüer

Ne lidhje me referatin e shokut Blagoje Neshkoviqit — mbajt ne mbledhjen plenare te Keshillit te pergjithshem te Frontit popullüer te Jugosllavis, foli shoku Eduard Kardel i cili ne mes tjerash tha:

„Nuk asht e nevojshme qe na sot ketu t'a bindim njeni tjetrin mbi faktin se sa asht i randesishem Fronti popullüer dhe sa asht kolosal roli i tij ne ndertimin t'one socjalist, sepse te gjithe rezultatet e korruna deri tash prej Frontit popullüer jane prova e randesis se Frontit popullüer dhe te rolit te tij te madh. Por n'anen tjeter, asht e pamohueshme se na veçanerisht ne ket vjet e kemi lane mbas dore punen ne sektorin e Frontit popullüer e se ne shum organizata t'ona asht çfaqe tendenca e nençmimit te Frontit popullüer dhe te rolit te tij, mbi çka dishmojne rezultatet e dobta te punes ne disa organizata te Frontit popullüer.

Na te gjithe e dijme se Fronti popullüer asht aleance e klases puntore me turmat tjera punuese, e ne ket aleance te klases puntore me turmat tjera punuese bazohet ndertimi i jone socjalist. Nga forcija e kesaj aleance mvaret rithmi i ndertimit t'one socjalist, mvaret se me çfare suksesi do t'a realizojme Planin t'one pesvjeçar dhe te gjitha detyret ne lidhje me te. Me e nençmue Frontin popullüer, me lane mbas dore punen ne sektorin e Frontit popullüer, nuk don me thane kurgja tjeter veçse me e indifrenue aleancen e klases puntore me turmat tjera punuese, d. m. th. me e minue bazen mbi te cilen mbeshtetet forcija e ndertimit socjalist ne Vendin t'one, mbi te cilen ne vijen e fundit, bazohet forcija e revolucjonit socjalist ne Vendin t'one si dhe pushteti i jone.

Une mendoj se na duhet pa tjeter me konkludue ne ket plenum se flakimi i gjanjeve te ketilla — i nençmimit dhe i lanjes mbas dore te Frontit popullüer - asht sot detyra e jone e pare dhe ma e randesishme politike.

Permbajtja e punes se Frontit popullüer ke na - tha shoku Kardel, nuk ka qene gjithmone e njillojt. E dijme se gjate luftes Fronti popullüer ka pase, para se gjithash, detyren e mobilizimit politik te shtresave popullore per luften e armatosun kundra okupatorve. Me njihere mbas luftes, detyra e pare e Frontit popullüer ka qene thyemja dhe izolimi politik i mbeturinave te reaksionit dhe mobilizimi i masave per ndertim. Ne fazen e pare te Planit t'one pesvjeçar, si me thane gjate pregaditjes t'anij ofensivet socjaliste te gjane dhe te pergjithshme, ne kend shtrue para Frontit popullüer si detyre e pare mobilizimin ekonomik te shtresave te popullit. Sot, kur ne realizimin e Planit t'one pesvjeçar dhe ne ndertimin e socjalizmit ketim pergjate me hapa serioz, qendron para neshe, para Frontit popullüer, ne rend te pare, detyre qe t'i aktivizoje edhe ma tutemt ne lufte kundra mbeturinave te reaksionit dhe ne lufte per ngritjen e vetdijes politike te turmave punuese. Na kemi para vedi armikun, i cili i ka humbe gropat, shum ma teper se sa ke qene borgjezija e qytetit si ndertarine e te kulaneve, ne vetdijen e turmave, armikun i cili asht i lidhun me zakonet e pronareve te vegjel, me mbeturinat e bestytnive, me paragjykimet etj.

Perforcimi i mbrendeshem i organizatave te Frontit popullüer, perforcimi organizativ dhe politik asht detyra e dyte e randesishme, te cilen ky plenum duhet t'a tranzmetoje n'organizatat e Frontit. Kur te flasim mbi perforcimin organizativ dhe politik t'organizatave t'ona, atehere duhet te luftojme se çashtja te mos mbetet vetem nje fjale, te mos e kthejme ket ne frazen e pergjithshme te „perforcimit", mobilizimit, çka shpesh here ngjet ke na. Punet duhet te merren aq konkretisht sikurse u vuen ne dukje ne referatin e shokut Neshkoviq dhe ne diskusjonin e shum shokve, te cilet konkretisht folen mbi ket çashtje.

Ke na sot, p. sh. filloi shum mbi luften kundra elementeve kapitalista, te cilet po e ashpersojne rezistencen e vet kundra ndertimit te socjalizmit. Perforcimi i organizatave themelore te Frontit popullüer - tha shoku Kardel duhet te jete bash ne hazen e forcimit per kah klasa t'aleances se klases puntore me turmat tjera punuese ne drejtim te kuptimit politik t'asaj aleance, ne kuptim te ngushtjes se telat t'asaj aleance kundra elementave kapitalista ne katund.

Mirepo, te na ende ne shum vende organizatat e Frontit popullüer konsiderohen ma teper si do organizata per mitingje politike ase si organizata per mbledhjen e fuqis puntore vullnetare, e ma pak si aleance organizative luftarake e popullit punues, e cila ne katund do te luftoje per ndertimin e socjalizmit kundra mbeturinave te kapitalizmit, kundra burokracis dhe elementave te tjere, te cilet e pengojne ndertimin socjalist.

Keshtu, keto jane dy punë, te cilat kam mendue veçanerisht me i vue nd dukje. Do te dishrojsha mendoj me i cekë edhe disa çashtje konkrete, te cilat u vuen ne dukje gjate diskusjonit.

Mendoj se nji nga dobesit ma te medhaja ne punen e organizatave themelore te Frontit popullüer qendron ne faktin se ata nuk u apin ndihme te mjaftueshme organeve ma te nalta udheheqese ne rastin e perpunimit konkret, te cilat duhet t'i drejtojne ata organizata. N'anen tjeter neper gazeta shkruhen artikuj dhe diskutohen pernjet ne menyre theorike, por mungon ndihma konkrete e perditshme per organizatat themelore te Frontit popullüer. Mendoj se, ne lidhje me ket, jane te randesishme veçanerisht dy gjana, te cilat duhet t'i permbkruej edhe nj here. Nuk mund t'u epet ndihma konkrete organizatave t'ona te Frontit, ne qofte se aparati i keshillave ekzekutive te Frontit popullüer neper, republika, te bile edhe neper rrethe, do te jete aq i dobet dhe i pazhvillue sikurse asht, kryesisht, tash. Udheheqesinat e Frontit popullüer nuk i perpunojne aq si duhet disa çashtje te punes t'organizatave t'ona themelore te Frontit, dergojne direktiva te pergjithshme, u çmuemit e pergjithesishem politik etj., te cilat transmetohen ma tej po ashtu te paperpunueme.

Prandaj, asht e domosdoshme me krijue bile minimumin e atij aparati te organeve, komisjoneve etj., pra trupave udheheqes te Frontit t'one popullüer mbi te cilet foli shoku Neshkoviq. Kjo nuk don me thane se te gjithe trupat t'one udheheqes do te bazohen vetem n'ato çka parashtroi shoku Neshkoviq. Mirepo, ky asht minimumi, i cili pa tjeter duhet t'a kete çdo keshill i jone i Frontit popullüer.

Çashtja e dyte, ne lidhje me ket, asht qe te likujdohet rranjesisht metoda e komandimit, thjesht e urdhnimit „duhet te bahet kjo e kjo", te qe njikohesisht te mos studjohen kushtet konkrete e qe se mos ndihmohen shoket me rastin e realizimit te detyreve, qe u parashtrohen. Gjithashtu duhet me e fillue nji lufte radikale kundra mbeturinave te sektarizmit. Shpesh here perjashtohen nje ceat e mire nga puna e Frontit dhe nga puna prane keshillave popullore, me gjithse ata do te mundshin me e ba nji sherbim shum te çmueshme.

Shum organizata t'ona te Frontit e kane perbmledhe planin e punes, pak a shum, me planet e veta ekonomike. Mirepo nuk perudhet ketu i tane plani i punes s'organizatave t'ona te Frontit. Ne qofte se permbledhen ne keto plani i punes s'organizatave te Frontit, atehere kjo bile asht dam i madh, sepse atehere organizatat e Frontit behen organ i thjesht per mobilizimin e per punen vullnetare. Asht e nevojshme qe organizatat t'ona te Frontit te hartojne planin e punes ne tanesi, d. m. th. planin e punes politike, edukuese, ekonomike etj. Planin e ketille duhet t'a kete çdo organizate e jone themelore e Frontit dhe atehere po tjeter duhet me kontrollue punen se si po zbatohet, me çfare gabimesh, me çfare suksesesh".

Tue fole mbi çashtjen e organizatave themelore te Frontit, shoku Kardel tha se kerkesa per krijimin e nji sistemi unik organizativ perna i perket organizatave themelore te Frontit, asht e drejte.

„Edhe ne qofte se i perforcojme organizatat t'ona themelore te Frontit, do te shtrojme perseri para Frontit ato detyre, te cilat Fronti duhet t'i kete, e bile edhe detyret politike e arsimore. Por kjo nuk do te thote se tash duhet te lejm, te nençmohen ose te braktisen format e punes t'organizatave te Frontit, sic asht puna e grupeve te Frontit neper rruge, blloqe etj. Puna e grupeve te ketilla asht jashtzakonshme e randesishme dhe kjo do te jete bash ajo lidhje direkte me shtresat e gjana te popullsis.

Gjithashtu, duhet me e kapue drejte edhe randesin e aktivave te Frontit ne lidhje me çashtjet e ndryshme. Ketu ka qene shtrue çashtja se aktivat e Frontit shpesh here dal perputhen me komisjonet prane keshillave popullore ase kooperativave etj. Simbas mendimit t'im, ne qofte se ndokund gjaqen pune te ketilla, domethane se ato aktivat ase komisjonet jane formue keq. Fronti popullüer nuk duhet te krijoje keshilla te veçanta qytetaresh, prane keshillave popullore, p. sh. ne lidhje me financat. Duhet me krijue aktivin e unjishem i cili do te bashkepunoje me pushtetin popullüer, me kooperativa dhe institucjone te tjera, qe gjinden atje.

Prandaj, asht e kjart se te gjitha keshillat e qytetareve etj. duhet te jene ne Frontin Popullüer dhe te punojne nde anen e Frontit popullüer.

Çashtja me randesi te jashtzakonshme, te cilen e parashtroi shoku Neshkoviq, asht çashtja e inspekcjonit, e pjesmarrjes se Frontit popullüer n'inspekcjonin popullüer. Pjesmarrja n'inspekcjonin popullüer e afron Frontin popullüer me detyre te perditshme te turmave, e n'anen tjeter ka tregue shtresave ne katund se Fronti popullüer asht organizate e tyne, te cila mundet me i ndihmue per zhdukjen e veshtiresinave te perditshme.

Edhe disa fjale mbi akcjonet e punes. Roli i ketyne akcjoneve te punes asht i randesishem jo vetem ne pikpamjen ekonomike, por edhe, para se gjithash, ne pikpamjen politike, ne pikpamjen e riedukimit te turmave. Eksperienca e sivjetme e brigadave te punes, veçanerisht ne Serbi, ka tregue se çfar roli mundet me luejte Fronti ne katund persa i perket lidhjes se turmave katundare me ndertimin socjalist. Brigadat e Frontit nuk duen me thane vetem nj marredhanje tjeter ndaj punes se katundarit, i cili asht mesue me punue ne copen e tokes se tij, porse kjo asht shprehje e marredhanjes se katundarit ndaj shtetit, ndaj ndertimit socjalist. Pjesmarrja masovike e katundarve ne brigadat punuese te Frontit, tregon se turmat t'ona punuese ne katund jane te lidhuna me ndertimin t'one socjalist, dhe se çka mund te baje, ne rast se perdoren drejte format perkatese organizative. Por, te gjitha ket randesi do t'a ruajnë ne qofte se punet vullnetare te mos jene me te vertete vullnetare. Bash ne ket vullnetarizem qendron edhe dhe roli politik i punes vullnetare. Posa te filloje me u shkele ky princip, puna e ketille mundet me qene e damshme jo vetem ne pikpamje ekonomike, por para se gjithash edhe ne pikpamje politike. Te mdu dhe gabime ne ket pune ka shum. Do te bajshim nji gabim te madh ne qofte se do t'a mshefim ket te vertete.

Ketu disa shoke i kendare disa akcjone te punes. Asht e shkeje qe i luvduem sepse kane pase randesi te madhe politike dhe ekonomike. Por, disa shoke kane harrue me kete rast me thane se atje ka pase edhe gabime te randa se ka pase kthe shkelje te principit te punes vullnetare. Ata me ket rast kane ba nji gabim edhe ma te madh, sepse ne qofte se nuk luftojme kundra shkeljes se principit te punes vullnetare, do t'i minojme akcionet e tana te punes vullnetare, do t'a diskreditojme punen vullnetare.

Kur te flitet mbi keto akcjone, asht e randesishme me te permende edhe punen se shpesh here keto kane qene te pregatituna ma keq se asht si duhet. Kjo vlene per akcjonet punuese republikane, te rretheve dhe tjera te rinis. Ka pase raste qe rinija ka ardhe atje dhe ka mbete urie. Ase ka qene aq dobet e vendosun sa qe te rijt jane sane nga semundjet e ndryshme. Keto nuk guxojme me e lejue ma dhe puna e ketille duhet te pushoje vendosmenisht. Edhe nuk me ndoj se do t'ishte e nevojshme qe ne princip te mos ndahet brigadat punuese te rinis nga akcjonet te pergjithshme te Frontit, vetem ne raste ma te randesishme, kur kjo asht e nevojshme. Perndryshej kryesisht, ne rrethimin lokal, nuk duhet me i ndu akcjonet punuese te rinis dhe nga ato te Frontit.

Ne fund, do te dishrojsha me e permend çashtjen e marredhanjes se Frontit popullüer dhe te sindikatave ne lidhje me vrejtjet e shokeve qe bane diskusjon. Shoku Neshkoviq theksoi nevojen se punetoret ne fabrika do te marrin pjese ne punen e Frontit popullüer simbas principit teritorjal, te mos ndahet dhe te mos veproje politikisht vetem ne deget e tyne sindikale. Kjo kerkese asht plotesisht e drejte dhe vetem e drejte. Kjo nuk don me thane se na po u marrim sindikatave rolin e edukuesit te klases puntore ase po i ndajme nga aktiviteti politik. Sindikati, jo vetem

(Vazhdon ne faqen e dyte)

Gara ne ndere te Kongresit te II te PKS dhe te Konferences se IV krahinore te PKS per Kosmet

Gara ne mes te brigadave punuese vullnetare te Frontit

Hovi i garave ne ndere te Kongresit te Dyte te Partis Komuniste te Serbis dhe te Konferences se IV Krahinore te PKS per Kosmet ka perfshi te gjitha kolektivet punuese e Krahines s'one. Perveç kesaj edhe njisit e punes se Frontit popullüer jane hie zhvillue gara dhe secila njisi lufton per korrjen e sukseseve sa ma te mdhaja. Brigada e Frontit e cila punon ne ndertimin e heburudhes industriale prej minieres «Kosova», u ka shpalle gara, ne ndere te Kongresit te II te PKS dhe te Konferences se IV Krahinore te PKS per Kosmet, brigades se IV te rrethit te Prishtines dhe brigades se V te rrethit te Gilanit ne lidhje me tejkalimin e normave, me punen kulturo-arsimor, me punen ideo-politike etj. Brigadat e kane pranue ftesen per gara dhe me nji here bane formue komisjonin perkates. Ne mes te brigadave me te vertete ka fillue nji pune e madhe se cilado t'ia kaloje tjetres. Komisjoni ka vendos me io dha ne flamurin kalimtar brigades qe do te dale fituese. Me daten 27 te m.k. e fitoi flamurin kalimtar brigada e III e rrethit te Lipjanit, e cila deri me atehere ka korre perfundime ma te mira. Brigadistat e kesaj brigade ka gezue shum kjo fitore e brigades se tyne dhe thone se do te luftojne vazhdimisht per t'a mbajte kete flamur edhe hendej e tutje.

Grumbullimi i tepricave te detyrueshme te mishit ne kohe ndihmon shum ne furnizimin e njerzvet t'one punonjes

[illegible]

Gjithnji po shtohen kooperativat katundare te punes ne krahinen t'one

[illegible]

Nga aktiviteti i brigades se Frontit popullor te rrethit Prishtine

[illegible]

Nga konferenca e trete e Partis komuniste ne Gilan

Para disa ditesh ne Gilan u mbajt konferenca e trete e Partis per rrethin e Gilanit ku mueren pjese 181 delegate nga organizatat themelore te Partis.

I deleguemi i Komitetit Krahinuer te PK te Serbis shoku Milija Kovaçeviq, e pershendeti konferencen dhe vueni ne dukje randesin e kesaj, „e cila po mbahet ne frymen e vendimeve historike te Kongresit te Peste te PKJ, dhe ne ditet kur kundra vendit t'one po bahet nji fushate e terbueme dhe e turpshme nga ana e disa vendeve demokratike, te cilat kane per qellim per me e zvoglue karakterin revolucjonar te luftes s'one per çlirimin kombtar dhe karakterin e luftes per nderlimin e socjalizmit ne Vendin t'one".

Referatin politik mbi zhvillimin dhe jeten e organizates se rrethit te Partis e dha shoku Milosh Xhudoviq, sekretar politik i Komitetit.

Ne referatin e vet shoku Xhudoviq e pasqyroi jeten e organizates se Partis qysh nga ditet e para te luftes se saje per nji jete ma te lumtun e ma te mire per nj tezit punues te Vendit t'one dhe vuni ne dukje rezultatet e korruna deri tash. Referatin organizativ e paraqiti shoku Sinan Hasani, i cili e pasqyroi shum kjarte gjendjen organizative t'organizatevet te Partis ne vjetet 1945-1948.

Mbas diskusjonit qe u zhvillue ne lidhje me referatet, u-ba zgjedhja e antarve te Komitetit te rrethit, komisjonit te revizjonit, e delegatve per Konferencen e IV Krahinore te Partis dhe per Kongresin e II te PKS.

Nga konferenca u derguen telegrame pershendetse shokut Tito dhe KQ te PKJ.

Me i kushtue ma teper kujdes ruejtjes se veglave dhe maqinave bujqesore

[illegible]

Nga jeta dhe nga puna e brigadave te rinis se Kosmetit n' Autostraden „Vllaznim-Bashkim" deri ne kethimin e tyne

[illegible]

K. Bilushmi

Minjera „Kosova"

Dega sindikale e minjeres »Kosova« Perveç detyrimeve tjera te marruna persiper ne ndere te Kongresit te Dyte te PKS dhe te Konferences se IV Krahinore te PKS per Kosmet, ka marre mbi vedi qe deri ne diten e mbajtjes se Kongresit te kryeje nji akcion te gjane pyllzimi rreth minjeres.

Antaret e deges sindikale dhe FAG-ut kane marre persiper me mbjelle gjate javes 50,000 fidane bagremi. Garat zhvillohen ne mes te grupeve te ndryshme sindikale. Qysh ne ditet e para asht shque grupi qe udhehiqet prej Zhiva Markoviqit. Grupi i ketij, per dy ore jo te plota, ka mbjelle 500 fidane.

[illegible]

Arsim e kulturë

Le t'i shumfishojme perpjekjet t'ona per pune sistematike ne luftimin e analfabetizmit

C'prej çlirimit e deri sot, ne Krahinen t'one kane mberrijte perfundime shume te mira ne punen per likuidimin e analfabetizmit. Punes per zhdukjen e analfabetizmit i jemi perveshe me seriozitet dhe te madh tue e ditë se kjo pune asht kusht i domosdoshem per ndertimin ma te shpejte te socjalizmit ne Vendin t'one.

Lufta per zhdukjen e analfabetizmit ne Kosove e Metohi asht zhvillue me hove mjaft te vrullshme, sepse asht dashte me luftue me shume veshtiresina, te cilat na kane mbete trashigim nga ish Jugosllavija. Por me gjithe keto jane korre perfundime shume te mira, prej vjeti ne vjet, ne punen per zhdukjen e analfabetizmit. Ne vjetin 1945 jane aftesue me shkrue e me kendue ne kete Krahinen t'one 3025 vete, ne vjetin 1945-46 jane mesue 25.266, ne vjetin 1946-47 jane mesue 31.965 e ne vjetin 1947-48 40.213 vete. Keto perfundime jane mberrijte me saje te perpjekjeve te popullsise, te ndihmes s'organizatave masovike dhe t'autoriteteve te ndryshme, te cilat e kane çmue drejte randesin e kesaj pune.

[illegible]

... me te dhi i kane rrethe analfabetizmit qe te vijne pa nderprerje ne per kurset kundra analfabetizmit.

Shperblimi nji i madh per ata qe kane korre perfundime te mira jane rezultatet e tyne ne pune, te cilat jane kontribut i madh per ndertimin e Vendit t'one per realizimin e Planit t'one pesvjeçar. Pushteti i jone popullor i çmon perpjekjet dhe punen vetmohuese te te gjithe atyne, te cilet luftojne per me e shpejtue ndertimin e socjalizmit. Keta luftetare nxirren ne dukje si shembull per te tjeret, lavdrohen dhe shperblehen. Si shembull po i marrim disa udheheqesa te kurseve kundra analfabetizmit. I riu Xhevat Abdyli nga Novosella e rrethit te Prizrenit, ka punue ne katundin e vet me dy kurse analfabetike dhe ka udheheqe nji kurs arsimtar, ne kushte mjaft te veshtira. Ky ka arrijte me i mesue shkrim e kendim 75 vete. Per punen e tij te vetmohueshme, kryesija e qeveris te RP te Serbis e ka shperblye me 15.000 dinare. Kata Vasiq, shtepijake, me kater femij te vegjel, me gjithse e zanon me pune te shumta, ka punue aktivisht me gra dhe ka arritë me i mesue 20 vete. Kjo asht shperblye nga ana e ministris s'arsimit te RP te Serbis me 5.000 dinare. Fadil Zeqo, punor ne minjeren „Golesh" me gjithe punen e madhe ne minjere, ka korre sukses ne udheheqjen e kursit analfabetik dhe i ka mesue 64 minatore. Per ket pune asht shperblye nga ana e Ministris s'Arsimit te RPS me 5.000 dinare. Dushan Andrejeviq, mesues ne katundin Shterpse ne rrethin e Ferizajt, me gjithe se ka punue ne shkolle me nji numer te madh nxanesish, ka mesue me shkrue e kendue 150 vete, per kete arsye asht shperblye nga ana e Ministris s'Arsimit te RP te Serbis me 5.000 dinare. Kesi shembuj ka edhe ma ne Krahinen t'one.

Me nga 5000 dinare jane shperblye udheheqesat: Ali Salihu nga rrethi i Dragashit, Orllovic Borka nga rrethi i Prishtines, Rexhep Bajrami nga rrethi i Drenices, Luf Bajrami nga rrethi i Gjakoves, Panteliqa Sadik Hoxha nga rrethi i Istokut, Saviq Branislav nga rrethi i Kamenices, Shaban Sahiti nga rrethi i Podujeves, Marie Veseli nga rrethi i Pejes, Hamza Sali nga rrethi i Ferizajt, Bajram Bajrami nga rrethi i Suharekes, Saviq Bozinka nga rrethi i Prizrenit, Riza Zhubi nga Mitrovica, Gjylsime Basha nga Peja, Shporta Qubeti nga Prizreni dhe Jakup Sahiti nga Prishtina.

Me nga 4.000 dinare jane shperblye: Mijoviq Dragaliub nga rrethi i Gilanit, Skender Azili nga rrethi i Dragashit, Ramadan Veseli nga rrethi i Prishtines, Simiq Millorad nga rrethi i Drenices, Isuf Sadiku nga rrethi i Gjakoves, Balkoviq Maksimi nga rrethi i Mitrovices, Ali Amzaviq nga rrethi i Istokut, Plakaj Uka nga rrethi i Kamenices, Ali Shabani nga rrethi e Podujeves, Ljuboviq Svetozar nga rrethi i Ferizajt, Billiloviq Dara nga rrethi i Pejes, Muharrem Qashi nga rrethi i Rahovecit, Shefki Berisha nga rrethi i Lipjanit, Suk Simeul nga rrethi i Suharekes, Jashar Xhemali nga rrethi i Prizrenit.

Perveç ketyne shperblimeve ne te holla Ministrija e Arsimit te RPS i ka shperblye edhe 121 udheheqesa te kurseve analfabetike me libra dhe [illegible] kurse Drejtorat i arsimit te Keshillit popullor krahinuer i ka shperblye nga ana e vet 190 udheheqesa te kurseve me te holla prej 500 deri 1.500 dinare.

Perveç kesaj Ministrija e Arsimit te RPS i ka shperblye edhe ato katunde te cilat jane shque ne punen kulturo-arsimore. Keto shperblime jane ba ne libra, dhe radjo-aparate me bateri. Ne biblioteka komplet jane shperblye katundet: Jasenovik i Posavem, rreth i Mitrovices, ku asht likuidue analfabetizmi deri ne 45 vjeç; [illegible] Srednja ne rrethin e Prizrenit, ku gjithashtu asht likuidue analfabetizmi; katundi Vitomirice ne rrethin e Pejes, ne Dakove ne rrethin e Vuçitrnes, Brezna ne rrethin e Dragashit, Dobnica ne rrethin e Podujeves, Lankoviq ne rrethin e Ferizajt, Minjera „Golesh" dhe katundi Sellogragjde rrethi i Suharekes. Radjo-aparate u jane dhurue katundeve Zllakuçan, rreth i Istokut dhe Malisheve rreth i Gilanit. Ne Zllakuçan jane mesue vjet me shkrue e kendue 100 femna shqiptare e sivjet do te likuidohet plotesisht analfabetizmi, e gjithashtu edhe ne Malisheve.

Keta shembuj pune dhe vetmohimi ne fushen e arsimit popullor, ne fushen e ndertimit te kultures socjaliste ne Vendin t'one, t'u sherbejne edhe udheheqesave te tjere te kurseve analfabetike gjate fushates se sivjeme per likuidimin e analfabetizmit.

J. Xh.

Aktiviteti i keshillave arsimore ne rrethin e Drenices

Me qene se ne rrethin e Drenices jane hape mjaft shkolla fillore te reja, e sidoemos nder katunde te largta, ku vendasve nuk u ka shkue mendja kurr nji here ma perpara se do te hapen shkolla shqipe edhe nder ato vise, ata kan fillue me e kuptue randesin e arsimit, prandaj po i dergojne bukur ne rregull femijt e tyne ne shkolle. Natyrisht, si ne fillim, keto shkolla nuk i kane pase te plotesueme te gjitha nevojat per klase e sidoemos bankat. Per plotesimin e ketyne orendive kane kallxue interesim dhe kujdes te veçante disa keshilla arsimore, te cilat meritojne me u vue ne dukje se e çmojne si duhet randesin e arsimit.

Mjaft aktiv asht kallxue keshilli arsimuer i katundit Beçiq, ku antaret e tij me punen dhe agjitacjonin e personave kane ba qe t'i perfshijne ne shkolle te gjithe femijt e katundit - mashkuj dhe femna, tue lshue edhe deklarate se nuk ka mbete asnji femi ne katund ne moshen e shkolles pa u perfshi ne te. Perveç kesaj keshilli ne fjale asht kujdesue per plotesimin e 15 bankave te reja katervendshe. Nder antaret e keshillit dallohen si ma aktiv Rrahman Shabani, Rexher Rrahmani dhe Bajram Hajdini.

Paralelisht me aktivitetin e ketyne keshilltarve shkon edhe ai i mesuesit te shkolles, i cili asht perpjeke me te gjithe fuqine e tija me e ba sa ma t'afert per katundaret shkollen - vendin e edukimit te femijve te tyne me frymen e te socjalistes.

R. Shatani

Shoqnija kulturalo-arsimore e qytetit te Gjakoves po luen rol n'edukimin e masave popullore

Ne kohet e fundit shoqnija kulturalo-arsimore „Koha e re" ne qytetin e Gjakoves ka kallxue nji aktivitet te madh, e veçanerisht me rastin e 29 Nandorit, dites se shpalljes se RFPJ.

Perveç te tjerave shoqnija ne fjale e ka korin e vet, i cili ban pregatitje te vazhdueshme, ne menyre qe te perfitoje personmeni ma te mire. Udheheqet prej profesorit Nuri Sherifi. Ne te bajne pjese 130 antare, e qe te gjithe nxanesa te shkollave te mesme, gja qe tregon se ne shoqni ende nuk jane perfshi mjaft antare nga masat e qytetit.

Per t'a luejte rolin e vet ashtu si munet, kjo shoqni me rastin e festes se 29 nandorit, qe te kremtohej sa ma solemnisht, organizoi nji program te pasun. U çfaqen dy pjese theatrale me permbajtje edukative, u kenduen disa kange nga kori, nji recitim si dhe u zhvilluen dy balete rase dhe valle folkloristike. Populli mbeti mjaft i knaqun nga paraqitja e ketij programi.

Shpresohet se shoqnija ne fjale do t'a shtoje edhe ma me intensivitet aktivitetin e vet dhe se udheheqesi i dramit shoku Apostol Taneli ka me ba qe te jepen çfaqje theatrale ma te shpeshta, mbasi ashtu asht deshira e masave popullore te qytetit.

Sh. Braha

Çfaqje theatrale

Mesuesit shqiptare e serbe te shkolles se Nakellit dhane para disa ditesh çfaqjen „Mbesa e krahinarit" ne gjuhen shqipe dhe „analfabeti" ne gjuhen serbishte, si dhe pjese nga kori e recitacjone.

Grupi ne fjale ka pase sukses ne keshillat e vendit: Treboviq, Stup, Drenovc, Leshan e Strellc. Ne te gjitha keto keshilla vendi jane mbledhe 3.500 dinare, te cilat ka dorzuen bibliotekes se shkolles. Keso pregaditjesh jane tue ba edhe mesuesat e shkollave te tjera.

I. V. SERGEJEV

Shkenca dhe bestytnija

Qysh prej kohe njerzit i kane shqetsue dukunit e jashtzakonshme qiellore — te zanunit e Diellit e te Hanes, paraqitja e kometave, kolonat shndritse, te ngrehuna deri ne qiell, kometet e shum dukuni te tjera, te cilat njerzia s'ka mujte me ia shpjegue vetevetes. Keto dukuni kane qene te pakuptueshme e prandaj edhe te tmerrshme.

Ndoshta, mendjet e pazhvillueme i ka habite ma se forti prej te gjithave nje hisht — kometa. Dukja e saje asht lidhe zakonisht me ndonji ngjarje te tmerrshme apo fatkeqesi, e cila duhet patjeter te rrzohet mbi njerzit. Prova ma e gjalle per popujt ishte lufta. Per ket arsye kometen e konsiderojshin te shumten e heres si lajmtaren e luftes.

Edhe njerzit e bestytnuem kane qene te bindun se asht kështu, sepse [illegible] mbas paraqitjes se kometes, diku shperthente lufta. Nuk u ka shkue kurr ne mend se lufta nuk i shkaktoi kometet, por diçka tjeter, shkaqe te [illegible]. [illegible] per pesedhjete vjetet e fundit. [illegible] me pa potlucajte s'ka kaluer [illegible] vjet, qe ne [illegible] e diku te mos te kete luftue ndokush. E gjate kesaj kohe jane duke gjithsej disa kometa. Prandaj, kometa ka me profetizue per pa gabue mbi luften, derisa njerzija te mos i zhduki shkaqet, te cilat shkaktojne luften.

[illegible] ma te vjetra, ia ka shti njeriut frigen dhe tmerrin e shkejt. Atje, ne qiell, si mbas mendimit te njerzit dike te pritrave, te cilet i kane binde ne te, asht ngjedhe fati i besimit dike fati i çdo qenje te gjalle. Besimi ne punen se jeta e njeriut asht e lidhun ngushtesisht me qiell, asht ruejtun deri edhe sot. Kjo gjoja lidhje ka qene e rrejshme e ruejtun ne shprehjen e njoftun mire prej te gjithve: ai ka le nen yllin me fat ase, mbasjellitas me hyllin fatkeq. Ka egzistue bindja se çdo njeri e ka hyllin e vet. Ai gjoja me rastin e lindjes se tij dhe vdes bashk me te: hylli i bie prej qielli e kjo tregon se ka vdeke njeriu.

Ky besim i rrejshem ka gjete pasqyrim edhe ne legjendat mbi Krishtin. Ne diten e lindjes se tij, gjoja asht djege ne qiell hylli i shndritshem, dhe mbas ndriçimit te ketij hylli mbretnit kane ardhe ne Jerusalem, t'i falen te posalindunit e si sjellin dhurata.

Ne shekullin e mesem ka qene veshtire me hase njeri, qe te dyshoje mbi influencen e hyjeve mbi fatin e tij.

Prej ketij besimi te rrejshem lindi shkenca e rrejshme-astrologjija. Astrologet studjojshin qiellin, ndjekshin me kujdes levizjen e planetive, levizjen e konstelacjoneve dhe simbas pozites se hyjeve qellore ne momentin e lindjes se njeriut, ia parathojshin fatin e tij.

Keshtu simbas mendimit t'astrologevet, njeriu qe linde nen shejin e Jupiterit patjeter do te fitonte nderim te madh, fame dhe pasuni, sepse Jupiter, me emnin e te cilit quhej planeti, ishte mbreti i zotnave te mitologjis. Ai qe lindte nen shejin e Marsit - kurse Marsin e mbajshin si zotin e luftes - domosdo te dallohej me karakterin luftarak dhe n'etjen per gjak, d. m. th. si duhej te bahej ushtar, mjek, kasap ase berber, qe lshon gjak.

Astrologet nuk i ka lodhte aspak lidhja e tetille e trillueme e mes te fatit te njerzve dhe te hyjve. Ata s'kane ça krye fort me ket mosmarreveshtje. Kerkesa te madha kane qene per astrologet. Çdo mbret, princ ase vojvode sundimtare konsideronte si per detyre te vetin t'i kete astrologet e vet, detyra e te cilit kishte me qene ajo me i profetizue zotnis mbi fatin e antareve te familjes se tij, perfundimin e luftnave diten e drejte, fatlume per çdo pune qe do te ndermerrej, qellimit e tij a kane me pasë sukses apo jo. Pozita e ketyne profetizatorreve, duhet t'a pranojme se s'ka qene e lehte. Shum prej ketyne i kane dhane fund jetes me varje ase ne burg. Disa prej tyne kane shpetue per hir te guximit dhe te mendjehollesis, sikurse u shpetoi astrologu i mbretit Luigji XI te Frances. Astrologet e paraprane vdekjen e nji dame t'oborrit mbretnuer, dashnores se mbretit. E ajo me te vertete vdiq. Ndoshta, edhe pa pjesmarrjen e vet t'astrologut, mbasi ata shpesh here kane perdore edhe aso mjetesh qe te forcojshin [illegible] e vet. Mbreti i idhnuem vendosi me e vra astrologun, e kur e thirri e pyeti: „qe pra, ti thue se din per t'ardhmen. Po me thuej, sa te mbet ty me jetue? Astrologu e kuptoi se i ka ardhe fundi, por tue mos e humbe kurajon, pergjegji: „ Zotni, hyjet nuk mbajne gja te mshefet prej meje, edhe ato me kane treguer se kam me vdek tri dite perpara vdekjes se madhnis se juej". Mbreti i bestytnuem [illegible] jo vetem nuk e vret mashtruesin, por asht perpjeke me çdo menyre t'a ruej prej rrezikut dhe prej vdekjes se pakohe.

Kurse nji astrolog tjeter francez, i biri i astrologut te shekullit XV te Nostradamusit, e perfundoi jeten e tij ne menyre te tmerrshme. Tue mos pase prirjen e t'atit, ai vendosi te fitoje fame - tue profetizue nji ngjarje te mrekullueshme - se qyteti Pyszen do te shkatrrohet prej zjarmi. Per sigurimin e profetis se vet, ai e ndezi vet qytetin, porse qytetaret e zune e denuen ate per ate.

Astrologjija ka qene shkence e rrejshme. Por astrologet tue vezhgue qiellin per shum vjet me rradhe i kane sjelle njerzimit dobi te madhe: materjali i çmueshem i vezhgimit te tyne ka sherbye shum si baze per shkencen ekzakte - astronomis. Edhe astronomet e pare, te tanishem kane qene astrologet. Po ashtu asht shkenca e rrejshme dhe alkimija, me ndihmen e se ciles njeriu perpiqej me i shnderrue metalet e thjeshta, n'ar, keshtu krijoi shkencen ekzakte - kimin. E ne saj te kesaj, njeriu mbertiji me e sundue natyren e materjes dhe mundet tash me bere transformime shum ma te madha, shum ma te çuditshme se sa qe asht kthimi i nji metali ne tjeter.

Besimi i kote mbi shejet qiellore, hyjet me fat, fuqit misterjoze, te cilet drejtojne fatin e njeriut, i kane ndihmue te gjitha menyrat, bile edhe sot nder shum vende klaset sundimtare i perkrahin, mbasi mesimi i kefilit u ndihmon qe mbajne popullin ne terrin e padijes e, te jene te bindshem.

Nji numer kolosal dukunish e zakonshem te pakuptim dhe plote bestytni te rrejshme, jane lshue ne qarkullim prej priftnave. Mbasi njeriu nuk e ka kuptue natyren dhe [illegible] prej ndikimeve te saja, u ka besue priftnave, u ka besue falltoreve e magjistoreve, te cilet mundin gjoja me ba mrekullina, u ka besue falltoreve dhe magjistoreve, te cilve u asht dhane gjoja aftesija me shique mbi t'ardhshmen, u ka besue hiromantve, te cilet tue shique vijat e shuplakes se dores kujshin se çka asht ba dhe se çka do te bahet me njerzin; u besonte te gjitha fallevet te ndryshme si ato me letra, me pasul me filxhan; u besonte andrrave profetike e çka ma teper besonte se mund te thirren shpirtnat dhe se mund te flitet me te vdekunit.

Frigen ma te madhe njeriu e ka pasë para vdekjes se paevitueshme por prap se prap te pakuptueshme. Priftnat e te gjitha kohnave kane pohue ne menyre te ndryshme se per shpirtin e tij te mire do ket bote, domethane po qe se ketu asht i munum dhe i bindshem, njeriu ka me mujte me e pase shperblimin e vet - parajsen dhe bekimin e amshuem ne boten tjeter. Njeriu i ka besue kesaj me gjithse askush dhe kurr nuk ka mujte me u bindë se ka ndonji bote tjeter.

Lajme nderkombtare

Pervjetori i XII i Kushtetutes Stalinjane

Popujt e Bashkimit Sovjetik kane festue ditën e Kushtetutes Stalinjane. Ka me kalue 12 vjete qysh se asht shpalle Kushtetuta Stalinjane ne mbledhjen e VIII-te te Sovjetit Suprem te BRSS me 5 dhetuer 1936. Ne te jane shprehe te gjitha ndrrimet themeltare ne Bashkimin Sovjetik si rezultat i revolucjonit te Madh socjalist te Tetorit; ajo ka ligjesue dhe ne te jane mbajte te gjitha ndrrimet ne Bashkimin Sovjetik si ne pikpamje, politike ashtu dhe ne pikpamje ekonomike, te cilet jane si rezultat i Kushtetutes Sovjetike te prueme ne vjetin 1924.

Prej pruemjes se Kushtetutes Stalinjane Bashkimi Sovjetik asht ba vendi i fuqishem industrijal. Ne baze te sovhozave dhe kolhozave asht krye rekonstruimi i bujqesis. Jane zhduke klasat antogenjate asht forcue aleanca ndermjet puntoreve dhe katundareve, asht ngrite inteligjenca e re popullore dhe asht forcue vllaznimi dhe bashkimi ne shtetin Sovjetik me shum kombe. Te gjitha keto jane pasqyrue ne Kushtetuten Stalinjane.

Kushtetuta Sovjetike ka karakterin e thelle demokratik. Demokracija e saj asht e drejte, demokraci per popull, per te gjithe njerzit punues sepse asht tjikenctarjsht e bazueme ne theorin marksiste-leniniste. Perkundrazi Kushtetua „demokratike" borgjeze e cila asht vetem maska e diktatures e te hollave, sundimi i nji grushti eksplatatoresh ajo ne te vertete asht plotfuqija e monopoleve kapitaliste, kurse jeta e padurueshme e masave eksploatuese.

Karakteri i thelle i Kushtetutes stalinjane shifet edhe ne trupin ma te nalte legjislativ te Bashkimit Sovjetik, ne Sovjetin Suprem te BRSS, i cili asht i zgjedhun bashke me Kushtetuten Stalinjane. Prej 1339 deputetve te Sovjetit Suprem 511 jane puntore; 349 katundare, kurse deputetet tjere jane ose udheheqesat e Partis ose udheheqesat e nji sektori tjeter, ose puntore ne fushen shkencore, kulturale dhe Partit. Me Kushtetuten Stalinjane grate gezojne te gjitha te drejtat me mashkujt. Ne Sovjetin Suprem te Bashkimit Sovjetik gjinden 277 gra. Me Kushtetuten Stalinjane edhe rinija ka fitue te drejta te gjana politike. Shum deputete te republikave sovjetike jane te rj. Deputeti i nji qarkut te nji republike autonome Cuvash — Katarina Ortulina ka pase 23 vjete kur ka qene e zgjedhun.

Ne Sovjetin Suprem asht e perfaqesueme edhe Armata Sovjetike. Shumica e marshallave dhe ushtarve, oficer dhe gjenerala te zgjedhun ne Sovjetin Suprem jane njerez te cilet ne luften e fundit kane trigue heroizmin dhe zotesi ushtarake. Ne Sovjetin Suprem gjinden 52 deputet te cilet jane heroj ne punen e ndertimit te socjalizmit. 18 akademik dhe 35 deputet te cilet kane fitue dhuraten Stalinjane. Ne permbajtjen nacjonale te Sovjetit Suprem asht mbajte edhe politika nacjonale e Bashkimit Sovjetik te ligjesuem ne Kushtetuten Stalinjane.

Roli i Kushtetutes Stalinjane nuk ka qene i madh vetem ne periudhen e paraluftes dhe ne periudhen e luftes s'adhes, por edhe ne periudhen e tanishme te zhvillimit te Bashkimit Sovjetik drejte komunizmit. Roli i saj historik nuk asht vetem per Bashkimin Sovjetik, por dhe per vendet tjera.

Kongresi i Dyte i Federacjonit nderkombtar te grave ne Budapest

Ne Budapest asht mbajte kongresi i II-te i Federacjonit nderkombetar i grave, ku kane marre pjese perfaqesuese e ... milioni antareve te ... organizate nga 15 shtete te botes. Kongresi u shqyrtue ne ... luftes per paqe, per te drejtat e grave ne te gjithe vendet e botes per nji jete te denje per njerzin, per mbrojtjen e nanes dhe te femijes.

[illegible]

Ne Vendim te Frontit antifashist te grues se Jugosllavis, shefi i delegacjonit Jugosllav Mitra Mitroviq ka paraqite Kongresit pershendetjen e ... dhe porosin e grave te Jugosllavis — grave luftare kundra fashizmit dhe ndertuese te socjalizmit — grave te mbare botes, per t'i bashkue te gjithe fuqit e veta ne kampin anti-imperjalist. ...

[illegible]

Telegramet pershendetse te grave te Beogradit

Kongresit te Federacjonit nderkombetar demokratik te grave.

Grate e Beogradit nga konferencat e veta i dergojne telegram pershendetes Kongresit te dyte te Federacjonit nderkombetar demokratik te grave, i cili mbahet ne Budapesht. Ne telegram pershendetes shprehin gatshmenin qe edhe ma tutje te forcojne Federacionin dhe mbrojtjen e paqes ne bote.

Ne telegramin e grave t'organizates themelore 22 dhe 24 te rejonit te katert, nder tjerash thuhet: „Na deshrojme paqe dhe luftojme kundra luftes, qe te mundemi me ndertue ne paqe jeten dhe ardhmenin ma te mire te femijve t'one".

Grat'e organizates themelore te Pestes te Frontit antifashist te grues te rejonit te Peste, tue e pershendete Kongresin e dyte te Federacjonit nderkombtar demokratik te grave shprehin besimin se Federacioni nderkombetare demokratik i grave do te luftoj si edhe deri tash me vendosmeni kundra agresionit, me te cilin pushtete - imbaflesit anglo - amerikan e rrezikojne boten.

Na femijte t'one i ngritim dhe i edukojme per krijimin e ardhmenit dhe jetes ma te mire, me deshire qe te mos shofim ma lufte, por sa ma shpejte ta ndertojme socjalizmin ne vendin t'one" — thuhet ne telegramin e grave t'organizates themelore Nr. 5 te rejonit te katert.

Fronti antifashist i grave te rejonit te dyte ne telegramin e tij protestoi kundra terorit monarko - fashist ne Greqi dhe kerkon qe Kongresi te merre masat te duhuna qe te lirohen nga burgu grate antifashist ne Greqi.

Telegrame pershendetse i kane dergue gjithashtu Konogresit edhe grat'e organizates themelore Nr.25 te rejonit te dyte dhe organizata themelore Nr. 9 te rejonit te katert.

Greva e nepunesave te komunikacionit n'Athine dhe Pirej

TASS-i lajmeron

Dje u mbajt greva njiorte e katersshe te puntorve dhe nepunesave te sherbimit te tramvajes dhe ferovis elektrike t'Athines dhe Pireut, i cili komunikacjon e lidhe Athinen me Piren. Grevistat kerkojne ndihmimin e rrogave dhe te mditjeve.

Gja e papritun ne qarqet monarko-fashiste per akuzat e Trumanit

Radio Moska bjen lajmet nga Athina qe qarqet e Athines gaditen pse Trumani ne referatin e Peste te tij ne Kongresin e SHBA mbi „ndihmen" amerikane Greqis, pergjegjesin per disfatat ne luftë kundra Armates demokratike i a lin Qeveris monarko-fashiste dhe Shtabit te pergjithshem, mbasi Qeverija e Greqis ka punue ne baze te direktivave t'Amerikanve, kurse me operacionet ushtarake ne te vertete kane udheheqe amerikanet, ndermjet te cilve General Fen Flit dhe misioni i tij ne Greqi.

MONARKO-FASHISTAT PUSHKATUEN 7 PATRIOT TE GREQIS NE SELANIK

Junajted-Pres lajmeron se dje jane egzekutue 7 patriote te Greqis, ndermjet te cilve edhe tri gra. Gjyqi monarko-fashist i ka denue per vdekje pse keta patriote e kane ndihmue Armaten demokratike popullore te Greqis.

Ne Varshave mbahet konferenca nderkombetare e ferovierve

Korrespodenti i TANJUG-ut lajmeron se ne Varshave filloj nji punen konferenca nderkombetare e ferovierve. Ne konference marrin pjese delegatet e Bashkimit Sovjetik, Polonis, Jugosllavis dhe shteteve tjera demokratike.

Kritika e jone

Probleme qe duen zgjidhje te shpejte ne bllokun e shtepijave Nr. 1 ne Prishtine

Ndertimi i shtepijave ne bllokun Nr. 1 te Prishtines e ka dhane mundesie shum familjeve te nepunesave te degeve te ndryshme qe ta lehtesojne deri diku zgjidhjen e problemit te banesave ne qytet, por ... plotesisht.

[illegible]

Rreth pyllzimit te vjeshtes ne Krahine

Ne baze te shenimeve deri me nji te kejij mueji, plani i pyllzimit te vjeshtes ne Krahinen t'one asht realizue ne 64,69 per qind. Jane mbjelle gjithsejt 1,608,600 fidane te ndryshme pyjore. Ne saje t'angazhimit te keshillave per ket akcjon dhe t'organizatave masovike, plani i pyllzimit te vjeshtes asht tejkalue ne disa rrethe. Ne rrethin e Liplanit jane mbjelle 21,000 fidane e ne rrethin e Ferizajt 14,100 ma teper se sa jane parapa ne plan. Ne rrethin e Suharekes plani i pyllzimit asht krye ne 79 per qind, e ne rrethin e Gjakoves ne 74per qind e n'ate te Drenices ne 64 per qind.

Siç duket nga vet rezultatet e deritashme, ne disa vene asht realizue dhe tejkalue plani i pyllzimit dhe, nder disa vende tjera asht afrue mjaft qe te realizohet. e kjo kuptohet nga vet fakti se akcjonet jane marre me seriozitetin e duhun dhe jane kuptue mire dobinat qe do t'in sjellin masave te gjana popullore. Perkundrazi ky akcjon asht organizue ma se dobti ne rrethin e Prizrenit, ku plani asht realizue vetem ne 22 per qind, mandej ne rrethin e Llapit ne 29 per qind, ne ate te Rahovecit ne 36 per qind. Nder rrethet e tjera perqindja e realizimit te planit levize prej 44-62 per qind

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Sipermarrja per shtyp dhe bo'ime "Milladin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimet ne fletoren i pranon Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.